



DVV International

Education for Everyone. Worldwide.
Lifelong.

ANKETA PËR ARSIMIN PËR TË RRITUR KOSOVË

2020-2021



die

German Institute for
Adult Education
Leibniz Centre for
Lifelong Learning



© 2021 DVV International
DVV International është Instituti për Bashkëpunim
Ndërkombëtar i Deutscher Volkshochschul-Verband eV (DVV),
Shoqata Gjermane e Arsimit për të Rritur.

Botuar nga:
DVV International Kosova

Rr. Rexhep Mala nr. 26
10000 Prishtinë
Kosovë
www.dvv-international.ge
www.dvv-international.de

Redaktorë: Ramadan Alija, Maja Avramovska,
Elisabeth Reichart, Sarah Widany

Grupi punues:
Emir Avdagic, Ramadan Alija, Maja Avramovska, Nana Cha-
bukiani, Ester Hakobyan, Elisabeth Reichart, Biljana Mojsavska
Manojlova, Lali Santeladze, Dr. Sarah Widany

Partner i projektit:
Instituti Gjerman për Arsim për të Rritur
Qendra e Lajbncit për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës
Heinemannstraße 12-14
53175 Bonn
Gjermani
www.die-bonn.de

Anketa e realizuar nga:
Rr. Lidhja e Prizrenit nr. 56
10000 Prishtinë
Kosovë
www.riinvestinstitute.org

Fotot e kopertinës: Getty Images/Ali Kahfi; Getty Images/gremlin
Dizajni gra ik: Natia Mzekalashvili
Shtypja: "ORIENT" – Prishtina
ISBN: 978-9951-9077-1-2

Me përkrahjen e:  Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	70
Hyrje	74
Metodologjia	75
Gjetjet e Anketës	77
Karakteristikat e prejardhjes së të anketuarve	77
Qasja në informacion rreth mundësive të të nxënit dhe udhëzimit.....	93
Pjesëmarrja në arsim dhe aftësim	95
Arsimi formal	9
Arsimi joformal	103
Të nxënit informal	113
Perceptimet për të nxënit e të rriturve	118
Të nxënit në distancë gjatë COVID-19.....	124
Shënime përmbyllëse	131
Aneksë.....	133



Maja Avramovska

Drejtoresh Rajonale
Kaukazi dhe Evropa Juglindore
DVV International



Dr. Elisabeth Reichart

Bashkëpunëtoresh Hulumtimi
DIE Bonn



Dr. Sarah Widany

Projektin e mbështeti fillimisht si
Udhëheqëse e Departamentit të Sistemit
dhe Politikave të DIE-s dhe më pas
si profesoreshë zëvendësuese në
Universitetin e Potsdamit.

Të nderuar lexues,

Në vitin 2019, DVV International dhe DIE Bonn filluan planifikimin dhe zbatimin e një projekti kompleks rajonal, synimi i të cilit ishte të analizohej niveli më i avancuar në fushën e arsimimit dhe edukimit për të rritur (ARr), si dhe pjesëmarrja e të rriturve në arsim dhe trajnim (të nxënimit formal, joformal dhe informal). Studimi cilësor u krye në Armeni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji dhe Kosovë, kurse anketa për arsimin për të rritur në Armeni, Gjeorgji dhe Kosovë.

Qëllimi i këtij projekti kompleks ishte kryerja e një analize gjithëpërfshirëse të sektorit të ARr dhe sigurimi i të dhënave që do të përdoreshin në fushën e krijimit të politikave dhe legjislacionit në sektorët e ARr, arsimimit dhe trajnimit profesional, punësimit, të nxënimit gjatë gjithë jetës dhe fushave të tjera relevante.

Studimet cilësore dhe sasore dhe raportet e 7 vendeve u realizuan dhe përgatitën nga gjysma e dytë e vitit 2019 deri në qershor 2021. Së pari u fillua me kryerjen e studimit sasior dhe me sigurimin e rezultateve fillestare filloi edhe zbatimi i studimeve cilësore.

Në zhvillimin e strategjisë evropiane për të nxënimit gjatë gjithë jetës, rol të rëndësishëm luan monitorimi i progresit përmes anketave të bazuara në të dhëna. Për vendet e përfaqësuara këtu (Armeni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji dhe Kosovë), studimet e paraqitura dhe anketat e ARr janë një përpjekje thelbësore për të siguruar një

pasqyrë gjithëpërfshirëse të të nxënimit e të rriturve, parakushteve dhe sfidave të tij.

Duke ndjekur nga afër Anketën për Arsimin e të rriturve (ARr - anketë e konsoliduar ndërkombëtare për të nxënimit e të rriturve) dhe në koordinim me partnerët bashkëpunues dhe përmes përfshirjes së ekspertëve kombëtarë, u identifikuan specifikat kombëtare dhe nevojat për informata. Kështu, pyetësi standard u përshtat me rrethanat kombëtare dhe u plotësua me pyetje shtesë mbi qëndrimet ndaj të nxënimit dhe motivimin, si dhe për nevojat arsimore dhe mbështetëse kundrejt ndryshimeve masive në tregun e punës. Duke reaguar ndaj pandemisë Covid-19 u shtuan me shpejtësi pyetjet mbi qasjen në arsim dhe të nxënimit (digjital) gjatë pandemisë. Rezultatet e anketës u përgjigjen një sërë pyetjesh dhe ofrojnë informacion për shkallën dhe cilësinë e të nxënimit të të rriturve. Si shpërndahen të nxënimit dhe qëndrimet ndaj të nxënimit në popullatën e rritur? Cilat grupe janë të përfshira më shumë apo më pak? A përdoren forma të veçanta të të nxënimit nga grupe të ndryshme? Çfarë roli luajnë kushtet socio-ekonomike, p.sh. konteksti i punësimit apo vendbanimi në zonat rurale apo urbane?

Raportet cilësore të vendeve ofrojnë informacion shtesë të thelluar mbi kontekstin specifik kombëtar të sistemit arsimor, vendndodhjen dhe promovimin e ARr, të mbledhura në studime cilësore nga një ekip ekspertësh ndërkombëtarë dhe kombëtarë sipas një

skeme standarde. Së bashku, të dy raportet përbëjnë një bazë të shkëlqyer për vendet pjesëmarrëse për të vlerësuar situatën aktuale në sfondin e objektivave të politikës arsimore dhe për të zhvilluar strategji politike për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të ARr.

Duke qenë se studimet janë kryer në katër vende sipas një skeme uniforme, krahasimi ofron mundësi shtesë për klasifikimin e situatës përkatëse kombëtare. Duke qenë se analiza dhe studime të tilla gjithëpërfshirëse për sektorin e ARr u kryen për herë të parë në të gjitha vendet e përfshira në këtë projekt, kemi besim se një numër institucionesh dhe organizatash qeveritare dhe joqeveritare në Armeni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Kosovë dhe më gjerë, do t'i shfrytëzojnë të dhënat dhe njohuritë nga këto studime.

Shpresojmë që këto raporte të ofrojnë një bazë për diskutime për zhvillimin e mëtejshëm të politikave dhe kështu të kontribuojnë për dizajn të bazuar në dëshmi të sistemit të ARr.

Shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë anëtarët e grupit punues së projektit, autorët dhe institutet hulumtuese për bashkëpunimin profesional dhe të frytshëm dhe rezultatet dhe arritjet e shkëlqyera, të cilat u arritën kryesisht gjatë periudhës sfiduese të pandemisë Covid-19.

Ju urojmë lexim të këndshëm!



Ramadan Alija

DVV International Kosovë
Drejtor ne nivel vendi

Parathënie

Studimi sasior për arsimimin e të rriturve (ARr) i kryer në Kosovë, është dokument që për herë të parë analizon aspektet sasiore të sistemit të ARr në vend. Kosova përballet me mungesën e të dhënave në nivel shtetëror për pjesëmarrjen dhe mospjesëmarrjen e të rriturve në proceset e arsimimit të vazhdueshëm. Fatkeqësisht, statistikave të ARr në Kosovë janë të pakta ndërsa sektori i ARr mbetet një nga sektorët më delikat në Kosovë. Statistikat e ARr janë bashkëndarë në mes të një numri të akterëve qeveritarë, sektorit të shoqërisë civile dhe ofruesve të tjerë të ARr. Kosova ende nuk ka një bazë qendrore të të dhënave për pjesëmarrjen në ARr.

Pjesëmarrja në ARr mbetet tejtejt e pabarabartë, sepse ata që kanë më shumë nevojë kanë tendencë të kenë më së paku mundësi për të marrë pjesë. Meqenëse arsimimi i të rriturve ka filozofitë kryesore të ndërtimit të kapitalit shoqëror, dhe nxitjen e përfshirjes sociale, pengesat që qëndrojnë në rrugën e sigurimit të mundësive të përshtatshme dhe të nevojshme për arsimimin e të rriturve dhe për gjenerimin e një kulture të mësimnxënies janë shpesh të pranishme në Kosovë. Këto barrierë duhet të kundërshtohen seriozisht dhe të minimizohen në mënyrë që të avancohet zhvillimi i ARr më të mirë në Kosovë. Pa i analizuar të dhënat në lidhje me pjesëmarrjen në arsimimin e të rriturve, vështirë se mund të zhvillohen propozime për politikave arsimore bazuar në fakte (politikave e bazuara në dëshmi).

Për t'i përmbushur këto sfida dhe për të kontribuar në profesionalizimin e sektorit të arsimimit të të rriturve dhe dialogun e politikave në lidhje me ARr në Kosovë, DVV International e realizoi këtë studim sasior për ARr duke përdorur metodologjinë e Anketës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (AES).

Për ekspertizë në kërkimet krahasuese ndërkombëtare, DVV International bashkëpunoi me Institutin Gjerman për Arsimin e të Rriturve (DIE). Ky studim u realizua bazuar në kornizën për prodhimin e statistikave të arsimit dhe mësimnxënies tërëjetësore në BE. Më konkretisht, anketa u realizua në përputhje me metodologjinë e vendosur për Anketat për Arsimin e të Rriturve në shtetet e BE -së.

Anketa u realizua me persona të rritur në Kosovë që mbulojnë të gjitha grupmoshat nga 18 deri në 64 vjeç, nga të gjitha komunat e Kosovës. Bazuar në rezultatet e këtij studimi sasior për arsimimin e të rriturve, ARr paraqet një mundësi të madhe për qeverinë e Kosovës, për ta përcaktuar vizionin e saj për një kulturë të mësimnxënies për të gjithë, duke përkrahur dhe promovuar politika dhe nisma të tjera me qëllim të përmirësimit të mundësive për popullin e vet për të marrë pjesë në arsimim, studim, punë dhe aktivitete të tjera sipas preferencave dhe prioriteteve të tyre të ndryshme: me fjalë të tjera për t'ia mundësuar mësimnxënien tërëjetësore tërë popullit të vet.

Kjo qasje mund të jetë e suksesshme vetëm kur kultura e mësimnxënies brenda shoqërisë kosovare të ndryshojë seriozisht. Kur kjo të ndodhë, kontributi arsimor në tablonë më të madhe të zhvillimit të shoqërisë dhe qëndrueshmërisë ekonomike do të bëhet i frytshëm.

Ky studim sasior për ARr në Kosovë, nga njëra anë do të jetë i dobishëm për zhvillimin e politikave për ARr të qeverisë dhe të ofruesve të tjerë të ARr, dhe nga ana tjetër për planifikimin strategjik të qëllimeve dhe aktiviteteve për organizatat tona partnere dhe për vetë DVV International në Kosovë.

Hyrje

Anketa për Arsimin për të Rriturit (AARr) është një nga burimet kryesore për të dhëna statistikore për të nxënit gjatë gjithë jetës në Bashkimin Evropian. Ajo përfshin tema mbi pjesëmarrjen e të rriturve në arsim dhe aftësim, përfshirë arsimin formal dhe joformal, si dhe të nxënit informal. Fatkeqësisht, statistikatat për të nxënit gjatë gjithë jetës janë të pakta teksa sektori i arsimit mbetet një nga sektorët më delikatë në Kosovë. Ekzistojnë disa sfida që e kufizojnë arsimin në Kosovë, nga infrastruktura e pamjaftueshme shkollore te performanca jo e kënaqshme e mësimdhënësve dhe gjithashtu mungesa e mekanizmave të duhur për sigurimin e cilësisë. Për të mbushur hendekët e të dhënave në arsim, [Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës Gjermane për Arsimin për të Rritur \(DVV International\)](#), së bashku me [Institutin Gjerman për Arsimin për të Rritur - Qendra Leibniz për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës \(DIE\)](#), ka iniciuar dhe mbështetur AARr-në e parë në Kosovë.

Anketa, e para e këtij lloji e zbatuar në Kosovë, u administrua nga [Instituti Riinvest për Hulumtime Zhvillimore](#). Objektivi kryesor i anketës ishte mbledhja e të dhënave që do të ishin një burim i besueshëm për hartim të politikave të informuara me dëshmi për sa i përket arsimit. Anketa u realizua gjatë periudhës tetor-dhjetor 2020 dhe është anketa më e madhe e kryer ndonjëherë për të nxënit gjatë gjithë jetës në Kosovë me një mostër përfaqësuese në nivel kombëtar prej rreth 2,400 të rriturve të intervistuar.

Rezultatet e përgjithshme të AARr-së tregojnë se arritjet arsimore në Kosovë janë relativisht të larta, duke kapur nivelet e mesatares së BE-së. Sidoqoftë, sipas anketës, gjatë vitit të kaluar ishte mjaft e ulët shkalla e pjesëmarrjes

së të rriturve në aktivitete të lidhura me arsimin formal dhe joformal. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes mund t'i atribuohet në masë të madhe situatës pandemike dhe masave kufizuese të lidhura me të. Gratë shfaqin sistematikisht nivele më të larta të pjesëmarrjes në të gjitha llojet e aktiviteteve arsimore/të të nxënit. Kushtet socio-ekonomike konsiderohen si pengesa kryesore ndaj pjesëmarrjes në arsimin formal, ndërsa arsyet familjare (d.m.th. detyrimet familjare) konsiderohen pengesa kryesore për pjesëmarrjen në aktivitete joformale. Përgjithësisht, të rriturit ishin të kënaqur me cilësinë e arsimit që kanë marrë nga aktivitetet e të nxënit në distancë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ndërsa pamundësia për t'u përfshirë në aktivitete praktike shihej si një nga disavantazhet kryesore të aktiviteteve të tilla. Për fundi, teksa gjuhët e huaja dhe njohuritë kompjuterike janë të kënaqshme, duket se prirja e lartë për emigracion do të jetë një nga sfidat më të ngutshme të tregut të punës për një kohë të gjatë.

Raporti i anketës është i organizuar në disa pjesë, si më poshtë. Pjesa vijuese ofron një përmbledhje të përgjithshme të metodologjisë së hulumtimit të përdorur për AARr-në në Kosovë. Pjesa 2 paraqet, diskuton dhe analizon gjetjet kryesore të anketës mbi karakteristikat e prejardhjes së të rriturve, qasjen në informacion në lidhje me mundësitë e të nxënit dhe pjesëmarrjen në arsim dhe aftësim. Sa i përket temës së fundit, anketa përqendrohet në arsimin formal dhe joformal, si dhe të nxënit informal. Për më tepër, kjo pjesë përfshin edhe perceptimet për të nxënit e të rriturve dhe aktivitetet e të nxënit në distancë të imponuara nga pandemia COVID-19. Pjesa e fundit jep konkluzionet.

Metodologjia

Anketa për arsimin për të rritur në Kosovë bazohet në kornizën për prodhimin e statistikave për arsimin dhe të të nxënësve gjatë gjithë jetës në BE. Më konkretisht, anketa u realizua në përputhje me metodologjinë e vendosur për Anketat për Arsimin për të Rritur në vendet e BE-së. Anketa u realizua me nxënës të rritur në Kosovë duke mbuluar të gjitha grupmoshat ndërmjet 18 dhe 64 vjeç në të gjitha komunat e Kosovës. Përmasa e mostrës u llogarit sipas kriterëve të cilësisë për AARr-në sipas rregullores së Komisionit për AARr 2016.¹¹ Për qëllimin e kësaj ankete, përmasa e mostrës është përfaqësuese në nivel kombëtar dhe është e shtresuar në nivelin komunal. Përmasa e mostrës, siç sugjeron rregullorja e mësipërme, u llogarit bazuar në kërkesat minimale për vendet me një popullatë më të vogël se një milion të moshës 25 deri 64 vjeç, pra 95 për qind interval besimi dhe marzh të gabimit prej 2 pikë përqindjeje. Bazuar në kërkesa të tilla, numri i përgjithshëm i të anketuarve të intervistuar ishte 2,391 (shih tabelën në Aneksin 1). Meqenëse regjistrimi i fundit është realizuar në vitin 2011, si njësisia kryesore e mostrës u përdor regjistri i zgjedhësve. Si një teknikë mostrimi u përdor Probabiliteti Proporcional me Përmasën (PPS). Kjo metodë e zbatuar gjerësisht siguron që ato familje (të përcaktuara si grupe njerëzish që normalisht flenë nën të njëjtën kulm dhe kanë së bashku) në lokacione më të mëdha kanë të njëjtin probabilitet të përfshihen në mostër si ato në lokacione më të vogla dhe anasjelltas. Kjo metodë lehtëson edhe planifikimin për punën në terren, sepse në secilën zonë të zgjedhur rastësisht brenda komunave intervistohet një numër i paracaktuar i të anketuarve, dhe ekipet e regjistruarve shpërndahen sipas kësaj llogaritjeje. Në fazën vijuese,

familjet u zgjedhën në zonën përkatëse. Intervali i kalimit u përcaktua duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të familjeve në një zonë specifike me numrin e vlerësuar të intervistave që do të kryheshin nga regjistruesi në zonën përkatëse. Për shembull, nëse do të kishte 120 familje në një lagje specifike, atëherë 120 pjesëtuar me 40 (numri mesatar i të anketuarve për regjistrues) do të jepte një interval kalimi prej 3, që do të thotë se është intervistuar dikush në çdo familje të tretë. Ekipet kanë vizituar familjen e parë të renditur, më pas në të katërtën, më pas në të shtatën, e kështu me radhë derisa të kryheshin 40 intervista në atë zonë ose lagje të veçantë. Hapi i fundit i strategjisë së mostrimit ishte përzgjedhja e të anketuarve. Me të hyrë në familjen e përzgjedhur, regjistruesit kanë identifikuar anëtarët e familjes të cilët mund të intervistoheshin sipas kriterëve të mëposhtme: (i) personi është 18 vjeç e lart, (ii) jeton në familje për të paktën 6 muaj dhe (iii) nuk është i sëmurë ose vuan nga ndonjë gjendje që mund ta pengojë të marrë pjesë në intervistë. Nëse disa anëtarë të familjes janë të pranishëm dhe i plotësojnë 3 kriteret, atëherë regjistruesit zgjedhin rastësisht 1 person sipas një procedure standarde të dakorduar. Për të siguruar përfaqësimin e moshës dhe gjinisë, brenda secilës familje, mes të gjithë anëtarëve të familjes mbi 18 vjeç, u përzgjedh ai/ajo që kishte datën e tij/saj të lindjes më afër datës së intervistës. Kriteri “data e lindjes” u aplikua bazuar në ditëlindjen më të afërt të ardhshme. Ku ishte e nevojshme, u kryen vizita pasuese në rast se askush në familje nuk ishte i pranishëm gjatë vizitës së parë. Anketa u krye duke përdorur teknikën PAPI (intervista personale me letër e laps). Në raundet e mëparshme të AARr-së të kryera në mbarë BE-në

¹¹ Burimet e rregullave relevante të BE-së janë të disponueshme këtu [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:Adult_education_survey_\(AES\)](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:Adult_education_survey_(AES))

dhe disa vende të Ballkanit është përdorur një pyetësor i standardizuar. Sidoqoftë, për shkak të specifikave të vendit, disa pyetje u kontekstualizuan dhe u bënë shtesa dhe/ose ndryshime në përputhje me këtë (p.sh. pyetjet në lidhje me migracionin, të hyrat e familjes, etj.). Instituti Riinvest ka një numër prej mbi 200 regjistruesis, secili prej të cilëve e njeh mirë kontekstin lokal dhe në veçanti nivelin rajonal, komunal dhe nën-komunal. Regjistruesit kanë punuar me grupe të ndryshme të targetuara, duke përfshirë qytetarë, biznese, organizata, institucione lokale dhe të ngjashme. Shumica e regjistruesve të përfshirë në këtë studim ishin studentë ose të sapodiplomuar, me një përfaqësim të madh të regjistrueseve femra, nga të gjitha komunitetet etnike. Për të fituar rezultate sa më të mira, regjistruesit me përvojë u kombinuan me ata të sapo rekrutuar. U organizua posaçërisht një sesion trajnimi për këtë anketë për t'u mundësuar regjistruesve të njihen me objektivat, nevojat dhe modelin e anketës, si dhe me temën e anketës. Metodologjia e aplikuar u përpunua në detaje së bashku me procedurën e administrimit të anketës, duke sqaruar se si do të përdoren të dhënat. Detajet e pyetësorit u shpjeguan dhe regjistruesit kanë kryer para-teste me njëri-tjetrin për t'u njohur më mirë me detajet e secilës pyetje. Si pjesë e aktiviteteve të trajnimit në lidhje me anketën, regjistruesit morën një doracak specifik të anketës që shpjegon rëndësinë dhe synimet e përgjithshme të anketës. Grupet e vogla (3 deri në 5) të regjistruesve u mbikëqyrën nga një mbikëqyrës që ishte caktuar nga Menaxheri i Anketës. Rreth 15% e intervistave janë ri-verifikuar nga mbikëqyrësit për të siguruar nëse anketa është

kryer me të anketuarit përkatës dhe/ose nëse përgjigjet e përzgjedhura korrespondojnë me ato të plotësuara nga regjistruesi. Këto pyetje mund të përfshijnë ato që konsiderohen më cruciale për përpjekjen e hulumtimit, si dhe çdo pyetje për të cilat përgjigjet origjinale sugjerojnë mospërputhje të mundshme. U krye edhe një kontroll pas përfundimit të mbledhjes dhe futjes së të dhënave. Të dhënat e mbledhura u verifikuan nga hulumtuesit për të kontrolluar nëse kishte ndonjë përgjigje irracionale ose përgjigje që nuk përputhej me pohimet fillestare. Kjo e ndihmoi ekipin për zbulimin e defekteve të mundshme brenda secilit pyetësor. Në rast të gjetjes së dështimeve logjike, ekipi i anketës së bashku me regjistruesin i telefonuan të anketuarit. Kontrolli logjik shërben edhe për të identifikuar pyetësorë të mbushur në mënyrë të rreme nga regjistruesit. Nëse është zbuluar ndonjë, ai është konsideruar i pavlefshëm dhe është përdorur një pyetësor zëvendësues. Të dhënat u analizuan duke përdorur STATA, softuer statistikor për shkencën e të dhënave, për të identifikuar mospërputhjet e mundshme ndërmjet variabla-ve.² Ndryshimet u bënë sipas rastit; në secilën fazë, kopjet e të dhënave u mbajtën nga individët që punuan në fletëllogaritjet dhe nga Menaxheri i Anketës. U kryen kontrole periodike, kryesisht përmes krahasimeve të mesoreve të variablave dhe shpërndarjeve nëpër skedarë, për të siguruar që të dhënat nuk janë ndryshuar, qëllimisht ose ndryshe. Pjesa me përvojë e ekipit i njeh nga afër kushtet në Kosovë dhe ka mbajtur kontroll të shkëlqyeshëm mbi regjistruesit dhe të gjitha fazat e mbledhjes dhe kodimit të të dhënave. U respektua Rregullorja e Përgjithshme e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave.

² Më shumë informata në lidhje me STATA janë të disponueshme në vegzën e mëposhtme <https://www.stata.com>

Gjetjet e Anketës

Karakteristikat e prejardhjes së të anketuarve

Kjo pjesë paraqet disa statistika të gjeneruara nga mostra e anketuar. Kjo siguron sfondin e të anketuarve në lidhje me karakteristikat e tyre socio-demografike, statusin e migrimit, arritjet arsimore, statusin e punësimit, si dhe të hyrat e familjes. Sa i përket gjinisë, 52 për qind e të anketuarve janë burra dhe 48 për qind janë gra. Sa i përket moshës së të anketuarve, figura 1 jep informacion në lidhje me frekuençën relative të grupmoshave të ndryshme në mostër.

Figura 1.

Shpërndarja e mostrës sipas grupmoshës (n=2391)





Figura 2 tregon shpërndarjen e mostrës sipas zonës gjeografike dhe strukturës gjinore brenda zonës së veçantë të banimit. Teksa rreth 42 për qind e të anketuarve jetojnë në qytete, 8 për qind jetojnë në periferi, dhe 50 për qind në zona rurale. Lidhur me strukturën gjinore brenda zonave të banimit, vërejmë se në qytete janë intervistuar më shumë gra sesa burra; e kundërta është e dukshme në zonat rurale³.

Figura 2.

Struktura gjinore sipas zonës së banimit (n=2391)




³Dallimi mund të jetë për shkak të disa normave shoqërore që mbizotërojnë në disa zona rurale. Për shembull, në zonat rurale, nëse janë të pranishëm burrat, që zakonisht janë kryefamiljarë, ata kanë prirje të insistojnë të intervistohen në vend të gruas nga e njëjta familje të zgjedhur rastësisht për intervistë.

Struktura e popullsisë ndryshon edhe për shkak të emigrimit të të rinjve drejt vendeve perëndimore. Duhet të theksohet se valët e emigrimit të kohëve të fundit pritet të kenë implikime në tregun e punës, pasi prirja për të migruar mes të rinjve mbetet e lartë. Përafërsisht 15% e të anketuarve deklaruan se kanë emigruar një herë për të paktën 6 muaj. Lidhur me shpërndarjen e atyre që kanë emigruar për sa i përket gjinisë, vërejmë se burrat priren të emigrojnë më shumë sesa gratë; teksa 63 për qind e të anketuarve që kanë emigruar ishin burra, vetëm 37 për qind ishin gra. Figura 3 jep informacion në lidhje me emigrimin sipas grupmoshave të ndryshme. Nga ata që kanë emigruar, 35 për qind janë të moshës 25-34 vjeç, të ndjekur nga grupmosha 35-44 vjeç me 21 për qind.

Figura 3.


Shpërndarja e të anketuarve që kanë emigruar për të paktën 6 muaj, sipas grupmoshës. (n=379)



Kur flitet për arsyet e kthimit në Kosovë pas emigrimit, siç ilustron në figurën 4, më shumë se 30 për qind përmendin arsyet familjare si faktorin kryesor të tërheqjes, të ndjekur nga 18 për qind që u kthyen pasi nuk mund të merrnin leje qëndrimi dhe 11 për qind që u kthyen për shkak të programeve të kthimit dhe ri-integrimit. Nga ana tjetër, arsyet më pak të zgjedhura për kthim përfshijnë shëndetin me 0.7 për qind, daljen në pension me 0.5 për qind, dhe të qenit viktimë e abuzimit me 0.2 për qind.

Figura 4.


Arsyet e kthimit nga emigrimi (n=379)



Për sa i përket emigrimit në të ardhmen, më shumë se 34 për qind e të anketuarve kanë plane për të jetuar dhe/ose punuar në një vend tjetër brenda tri viteve të ardhshme. Mes atyre që planifikojnë të emigrojnë, 57 për qind janë burra dhe 43 për qind janë gra. Figura 5 tregon strukturën gjinore të atyre që kanë në plan të emigrojnë, sipas grupmoshës; përveç kësaj, vija në këtë figurë jep informacion në lidhje me prirjen për të emigruar për secilën grupmoshë. Siç mund të shihet, të rinjtë (të moshës 18-24 vjeç) kanë më shumë plane të emigrojnë sesa grupmoshat e tjera.

Figura 5.


Shpërndarja e të anketuarve që planifikojnë të emigrojnë brenda 3 viteve, sipas grupmoshës dhe gjinisë (n=818)



Kur u pyetën pse po planifikojnë të migrojnë, arsyet më të zakonshme përfshijnë kushte më të mira pune me 22 për qind, paga më të larta me 20 për qind, dhe qasje më të lehtë në tregun e punës me 18 për qind. Për dallim, ndër arsyet më pak të zakonshme të përzgjedhura përfshihet shëndeti me 1.5 për qind (figura 6).

Figura 6.


Arsyet për planifikimin e emigrimit. (n=818)



Arritjet arsimore në Kosovë, në përgjithësi, janë të ngjashme me mesataren e BE-së.⁴ Të dhënat tregojnë se më shumë se një e treta e të rriturve në Kosovë kanë përfunduar një program të arsimit të lartë, ndërsa vetëm rreth 2% kanë vetëm arsim fillor ose edukim të fëmijërisë së hershme. Kur të dhënat zbërthehen sipas gjinisë, mund të shihet se mes të rriturve me arsim të lartë të përfunduar, numri i grave është sistematikisht më i lartë sesa i burrave, përveç në nivel doktorature ose diploma ekuivalente. E kundërta vlen kur flitet për arsimin e mesëm të lartë, pas atij të mesëm ose me cikël të shkurtër (figura 7).

Figura 7.

Arritjet arsimore: zbërthimi sipas gjinisë (n=2391)




⁴ Statistikat për arritjet arsimore në BE të disponueshme në https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Educational_attainment_statistics

Të dhënat mbi arritjet arsimore zbërthehen më tej bazuar në shkallën e urbanizimit në të cilin jetojnë të rriturit e intervistuar. Siç pritej, në krahasim me periferitë dhe zonat rurale, jetesa në qytete shoqërohet me arritje të arsimit të lartë. Më shumë se gjysma e të rriturve me diplomë bachelor ose më të lartë jetojnë në zona urbane (figura 8).

Figura 8.


Arritjet arsimore bazuar në shkallën e urbanizimit (n=2391)



Përveç arritjeve arsimore, anketa mbledh të dhëna për statusin e punësimit të të rriturve. Sipas statistikave zyrtare tremujore të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit të kaluar shkalla e papunësisë shkante nga 25 deri në 27 për qind.⁵ Të dhënat tona tregojnë se shkalla e papunësisë ishte pak më e lartë krahasuar me të dhënat zyrtare gjatë së njëjtës periudhë; shkalla e përgjithshme e papunësisë ishte 30%, ndërsa të dhënat e zberthyera sipas gjinisë janë në përputhje me statistikat zyrtare (figura 9). Dallimet në të dhënat e punësimit mund të ndodhin për shkak të ndryshimeve metodologjike, si dhe mund t'i atribuohen faktit se anketa u realizua gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020, kurse statistikat zyrtare të lidhura me tregun e punës për tremujorin e katërt nuk janë botuar ende.

Figura 9.

Statusi i punësimit sipas variablave sociale dhe demografike (n=2391)




⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregut të Punës T1-T3 2020. Të disponueshme në: https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdataLabour%20market01%20Quarterly%20labour%20market/A_tab1.px/?rxid=35201751-6c43-42f5-8a26-c84c5562e670

Struktura profesionale e të rriturve të punësuar, me orar të plotë dhe me orar të pjesshëm, përshkruhet në figurën 10.

Të dhënat e mbledhura për profesionet zërthehen në nivelin dy shifror bazuar në strukturën ISCO-08; megjithatë, për shkak të numrit të ulët të vëzhgimeve për shumicën e kategorive, ato janë grumbulluar në nivelin një shifror. Tregu i punës dominohet nga punëtorët e shërbimeve dhe shitjeve, si dhe profesionistët (p.sh. profesionistët e shëndetit, profesionistët e mësimdhënies, etj.), me më shumë se gjysmën e të rriturve të punësuar (figura 10).

Figura 10.


Kategoritë profesionale (n=1364)



Zbërthimi i të dhënave profesionale sugjeron disa ndryshime gjinore sa i përket statusit të punësimit. Mes të punësuarve, shumica e profesioneve dominohen nga burrat; veçanërisht operatorët e impianteve dhe makinerive, punëtorët zejtarë dhe të aktiviteteve shoqëruese, si dhe punëtorët e bujqësisë. Nga ana tjetër, punësimi i grave, në krahasim me atë të burrave, është më i lartë në kategoritë e profesioneve të tilla si punëtorë të mbështetjes në zyra, si dhe teknike dhe profesionistë të asociuar (figura 11).

Figura 11.

Kategoritë profesionale sipas variablave sociale dhe demografike (n=1364)




Të dhënat mbi të hyrat sugjerojnë se rreth 40 për qind e familjeve fitojnë mes 400 euro dhe 800 euro në muaj. Pothuajse një e pesta e familjeve në Kosovë gjenerojnë mes 250 dhe 400 euro në muaj, ndërsa 7 për qind e familjeve marrin më pak se 250 euro në muaj. Pjesa e mbetur e familjeve (35%) fitojnë më shumë se 800 euro në muaj (21 për qind mes 800 dhe 1200 euro, 10 për qind e familjeve fitojnë mes 1200 dhe 2000, dhe 4 për qind gjenerojnë më shumë se 2000 euro në muaj).

Kur të dhënat për të hyrat zbërthehen sipas shkallës së urbanizimit në të cilën jetojnë familjet, të hyrat totale familjare, siç pritet, ndryshojnë mes zonave rurale dhe urbane. Familjet që krijojnë të hyra më të larta janë më të përqendruara në zonat urbane (figura 12).

Figura 12.


Të hyrat familjare sipas treguesit gjeografik (n=2391)



Për më tepër, kur të dhënat e të hyrave zërthehen sipas përkatësisë etnike, shohim se nuk ka dallime të rëndësishme mes grupeve etnike. Sidoqoftë, pjesa e komuniteteve jo-shumicë (d.m.th. serb, turk, boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptas) është pak më e lartë në grupet me të hyra më të ulëta (figura 13).

Figura 13.

Të hyrat familjare sipas grupeve etnike (n=2391)



Në anketën e AARr-së në Kosovë, të anketuarit u pyetën edhe për njohuritë e gjuhëve të dyta; rezultatet tregojnë se më shumë se 66 për qind mund të flasin të paktën një gjuhë të dytë ose më shumë. Vija në figurën 14 tregon fraksionin e secilës grupmoshë që mund të flasë të paktën një gjuhë të dytë; kolonat tregojnë strukturën e atyre që mund të flasin një (ose më shumë) gjuhë të dytë për sa i përket statusit profesional brenda një grupmoshe të caktuar. Në përgjithësi, të rriturit e punësuar kanë më shumë gjasa të jenë në gjendje të flasin një gjuhë të dytë sesa grupet e tjera. Për më tepër, të rriturit më të rinj flasin gjuhë të dyta më shumë sesa të moshuarit.

Figura 14.


Njohja e gjuhëve të dyta sipas grupmoshës dhe statusit të punësimit (n=1580)



Lidhur me njohjen e gjuhëve të tjera, të anketuarit mund të zgjidhnin deri në tri gjuhë të dyta. Figura 15 ilustron se sa shpesh janë zgjedhur gjuhë të ndryshme. Siç mund të shihet, anglishtja u zgjodh më së shpeshti me 58.5 për qind, e ndjekur nga gjermanishtja dhe serbishtja me 14 për qind secila.

Figura 15.


Njohja e gjuhëve të dyta (n=1580)



Përveç shkathtësive gjuhësore, edhe njohuritë digjitale janë faktor shumë i rëndësishëm për punësueshmërinë e fuqisë punëtore dhe zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të një shoqërie. Figura 16 tregon nivelin e njohurive që të anketuarit mendojnë se kanë për shkathtësitë digjitale të paraqitura. Kur flitet për regjistrim në kurse online, 30 për qind e të anketuarve nuk kanë njohuri themelore si ta bëjnë këtë. Një shkathtësi tjetër që u mungon një përqindjeje relativisht të lartë të të rriturve (18 për qind) është njohuria për aplikacionet kompjuterike siç është Microsoft Office. Nga ana tjetër, 44 për qind e të anketuarve konsiderojnë se kanë njohuri të përparuara në përdorimin e kërkimit në internet, dhe 41 për qind të tyre në përdorimin e rrjeteve sociale.

Figura 16.

Njohuritë për shkathtësi digjitale (n=2391)



Qasja në informacion rreth mundësive të të nxënit dhe udhëzimit


Përveç pjesëmarrjes aktuale në aktivitetet e të nxënit, kjo pjesë paraqet gjetjet kryesore në lidhje me qasjen në informacion në lidhje me mundësitë rreth të nxënit dhe udhëzimit. Së pari, të rriturit e intervistuar u pyetën nëse kanë kërkuar ndonjë informacion në lidhje me mundësitë e të nxënit gjatë 12 muajve të fundit para intervistës. Pas kësaj, ata që kanë kërkuar këtë lloj informacioni u pyetën nëse e kanë gjetur informacionin apo jo. Për fundi, të anketuarve që e kanë gjetur informacionin të cilin u duhej, iu kërkua që të për-

mendnin burimet kryesore të këtij informacioni. Rezultatet e anketës tregojnë se 33 për qind e të anketuarve kanë kërkuar informacion në lidhje me mundësitë e të nxënit. Sa i përket gjinisë, prej atyre që kërkojnë informacion, 46.5 për qind ishin burra ndërsa 53.5 për qind ishin gra.

Kur u pyetën nëse e kanë gjetur informacionin që kërkonin, 94 për qind u përgjigjën pozitivisht; përqindja e lartë tregon se qasja në informacion nuk është problem.

Figura 17.


Shpërndarja e atyre që kërkojnë informacion në lidhje me mundësitë e të nxënit, sipas moshës dhe gjinisë (n=794)



Të dhënat e paraqitura në figurën 17 tregojnë se të rinjtë kanë kërkuar informacione në lidhje me mundësitë e të nxënit më shumë sesa të rriturit më të mëdhenj në moshë; vija në këtë figurë tregon pjesën e atyre që kërkojnë informacion për secilën grupmoshë; kolonat ilustronë strukturën gjinore brenda grupmoshës.

Figura 18.

Burimet e informacionit në lidhje me mundësitë e të nxënit (n=747)



Siç tregohet në figurën 18, burimet kryesore të informacionit në lidhje me mundësitë e të nxënit ishin interneti (pa përfshirë rrjete sociale) i zgjedhur nga 21 për qind, kolegët nga 16 për qind, dhe rrjetet sociale nga 14 për qind e të anketuarve. Nga ana tjetër, burimet më pak të zakonshme të informacionit përfshijnë reklama në rrugë, billborde, autoritetet lokale dhe organizatat e shoqërisë civile. Edhe punëdhënësit kanë pak rëndësi në

kërkimin e informacionit në lidhje me mundësitë e të nxënit.

Dëshmitë treguan se të rriturit në të rinj kërkojnë informacion në lidhje me mundësitë e të nxënit më shumë sesa të rriturit më të moshuar, dhe se qasja në këtë informacion nuk është e vështirë; përveç kësaj, interneti, rrjetet sociale dhe kolegët janë burime të rëndësishme të këtij lloji të informacionit.

Pjesëmarrja në arsim dhe aftësim

Kjo pjesë shqyrton pjesëmarrjen dhe pengesat ndaj pjesëmarrjes në arsimin formal dhe joformal. Me konkretisht, këtu theksohen një gamë e gjerë çështjesh që lidhen me sektorin e përgjithshëm të arsimit në Kosovë, siç janë qasja, financimi, metodat e mësimdhënies, etj. Veç kësaj, këtu mbulohej edhe disa aspekte në lidhje me të nxënit informal mes të rriturve në Kosovë.


Arsimi formal

Arsimi formal përcaktohet si një formë e strukturuar dhe sistematike e të nxënit që zakonisht zhvillohet në mjedise shkollore ose institucione të tjera arsimore dhe plotësohet me një kualifikim të njohur nga autoritetet relevante kombëtare. Shkalla aktuale e pjesëmarrjes në arsimin formal në Kosovë vlerësohet nga të dhënat e të anketuarve për pjesëmarrjen e tyre në studime për kualifikime gjatë 12 muajve të fundit. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga anketa, vetëm 14 për qind e të rriturve kanë marrë pjesë në

arsimin formal gjatë 12 muajve të fundit, nga të cilët pothuajse 60 për qind ishin gra. Pjesëmarrja më e lartë e grave është më e theksuar në mesin e gjeneratave më të reja, ndërsa e kundërta është e dukshme për të rriturit në të dyzetat dhe të pesëdhjetat. Shkalla e pjesëmarrjes është e ndërlidhur negativisht me moshën; shkalla më e lartë (65%) është për grupmoshën 18-24 vjeç, ndërsa vetëm 2 për qind e të rriturve mbi 45 vjeç kanë marrë pjesë në arsim formal gjatë vitit të kaluar (figura 19).

Figura 19.


Pjesëmarrja në arsimin formal sipas grupmoshës dhe strukturës gjinore brenda grupmoshës (n=336)



Përveç strukturës gjinore, shkalla e pjesëmarrjes në arsimin formal zbërthehet më tej sipas nivelit të të hyrave mujore të familjes (figura 20). Shkalla e pjesëmarrjes brenda kategorive të të hyrave rritet me rritjen e të hyrave mujore të familjes. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes (19.2%) është në familjet që fitojnë më shumë se 2,000 euro në muaj.

Figura 20.


Pjesëmarrja në arsimin formal sipas kategorisë së të hyrave (n=336)



Pjesëmarrja në arsimin formal, siç pritej, është më e lartë tek të rriturit me nivele të larta të arritjeve arsimore; të diplomuarit dhe pasuniversitarët raportuan përqindje shumë më të larta të pjesëmarrjes krahasuar me të rriturit e tjerë me nivele më të ulëta të arritjeve arsimore. Më shumë se 18 për qind e të rriturve me diploma doktore ose ekuivalente, raportuan se kishin marrë pjesë në një program arsimor formal gjatë vitit të kaluar. Pjesëmarrja është më e lartë në mesin e atyre me diplomë master ose bachelor, me përkatësisht 29 dhe 19 për qind të të anketuarve që kanë marrë pjesë në një aktivitet arsimor formal gjatë vitit të kaluar (figura 21).

Figura 21.


Pjesëmarrja në arsimin formal sipas nivelit arsimor (n=336)



Shkencat sociale, në përgjithësi, mbeten fusha më tërheqëse e studimit për të rriturit në Kosovë. Pothuajse gjysma e të rriturve të intervistuar aktualisht janë duke ndjekur një program studimi, dhe në krye qëndron fusha e edukimit (22.8%), e ndjekur nga administrim biznesi dhe juridik (14.2%), dhe shkencat sociale, gazetaria dhe informacioni (9.3%). Duhet të theksohet se vetëm teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), inxhinieria, ndërtimi dhe bujqësia, dominohen nga burrat, ndërsa profilet e tjera duket se janë më tërheqëse për gratë (figura 22).

Figura 22.


Profilet e studimit sipas strukturës gjinore (n=336)



Më shumë se gjysma e të rriturve që kanë marrë pjesë në aktivitete të arsimit formal deklaruan se nuk kanë punuar gjatë periudhës së studimit. Teksa shumica nuk janë studentë të punësuar me pagesë, pjesa tjetër i ndjekin aktivitetet e lidhura me arsimin formal gjatë orëve të punës ose jashtë orarit të punës (me pagesë). Më konkretisht, 15 për qind e të rriturve që kanë ndjekur ndonjë lloj arsimit formal gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, e kanë bërë këtë jashtë orarit të punës. Nga ana tjetër, gati 10 për qind kanë pasur leje të frekuentojnë shkollën ose institucione të tjera arsimore gjatë orarit të punës (figura 23).

Figura 23.


Frekuentimi i arsimit formal (n=336)



Programet e arsimit formal të frekuentuara nga të rriturit gjatë 12 muajve të fundit në Kosovë, mesatarisht zgjasin rreth 19 javë. Siç tregon figura 24, një e treta e të rriturve të intervistuar raportuan se programi që po ndjekin zgjat ndërmjet 16 dhe 30 javëve, ndërsa 13 për qind e tyre ndjekin programe që zgjasin më shumë se 30 javë. Pjesa tjetër (më shumë se gjysma) ishin më të interesuar për programe më të shkurtra, nga 1 në 15 javë gjithsej.

Figura 24.


Kohëzgjatja e arsimit formal (n=336)



Pavarësisht nga kohëzgjatja e programeve të arsimit formal, ekzistojnë disa pengesa të dukshme ndaj pjesëmarrjes me të cilat përballen aktualisht të rriturit. Fatkeqësisht, kushtet socio-ekonomike duket se janë ndër pengesat kryesore për pjesëmarrjen në arsimin formal. Të dhënat e anketës tregojnë se në mesin e atyre që nuk kanë marrë pjesë në asnjë lloj arsimit formal gjatë 12 muajve të fundit, një e katërta e tyre nuk ishin në gjendje ta bënin këtë për shkak të detyrimeve të ndryshme të lidhura me familjen. Një pjesë më e vogël e tyre (13%) deklaruan se nuk kanë nevojë për arsim formal për detyrat që janë duke kryer në punën e tyre aktuale, ndërsa 11 për qind deklaruan se deri më tani nuk kishin nevojë për kualifikim formal. Nga ana tjetër, detyrimet e punës përmenden si pengesë ndaj pjesëmarrjes në arsimin formal (8.3%). Edhe pengesat financiare janë pengesa serioze kur flitet për frekuentimin e programeve të arsimit formal. Tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë janë të përballueshme për pjesën dërrmuese të të rriturve në Kosovë. Teksa studentët jo të punësuar me pagesë që jetojnë në familje që marrin ndihmë sociale janë të përjashtuar nga tarifat e shkollimit, transporti dhe kostot e tjera të jetesës duket se janë të papërballueshme për gati 7 për qind të të rriturve që deklaruan se do ta kishin frekuentuar shkollën nëse nuk do të ishte tepër e kushtueshme për ta. Lista e plotë e pengesave ndaj pjesëmarrjes në arsimin formal jepet në figurën 25 më poshtë.

Figura 25.

Arsyet për mospjesëmarrje në arsimin formal (n=2055)



Arsimi joformal

Ndryshe nga arsimi formal, arsimi joformal kryesisht nuk çon në një kualifikim të njohur në të gjithë vendin, dhe realizohet përmes programeve të strukturuar ose aktiviteteve të veçanta arsimore të dizajnuara për të përmirësuar një sërë shkathtësish dhe kompetencash, jashtë kurikulës arsimore formale. Shkalla e pjesëmarrjes në aktivitetet e arsimit joformal është relativisht e

ulët, çka në një farë mase mund t'i atribuohet pandemisë COVID-19 dhe kufizimeve të lidhura me të. Sipas të dhënave të anketës, pjesëmarrja kumulative në të gjitha llojet e aktiviteteve joformale është vetëm 13 për qind. Ngjashëm me arsimin formal, niveli i pjesëmarrjes së grave është më i lartë; 54 për qind e atyre që kanë marrë pjesë në ndonjë lloj aktiviteti arsimor joformal janë gra.

Figura 26.


Pjesëmarrja në arsimin joformal sipas grupmoshës dhe gjinisë (n=304)



Siç pritej, shkalla e pjesëmarrjes është më e lartë tek të rriturit e rinj, dhe ulet me rritjen e moshës (figura 26). Pothuajse 78 për qind e pjesëmarrësve janë mes 18 dhe 34 vjeç. Kurset janë aktiviteti kryesor i arsimit joformal për më shumë se gjysmën (57%) e pjesëmarrësve, të ndjekur nga trajnimet me udhëzime në punë, punëtoritë dhe mësimet private (figura 27).

Figura 27.


Aktivitete të arsimit joformal (n=304)



Ngjashëm me arsimin formal, të dhënat tregojnë korrelacion pozitiv mes shkallës së pjesëmarrjes në arsimin joformal dhe të hyrave të familjes. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes është mes familjeve me 800-1,200 euro të hyra mujore (figura 28).

Figura 28.


Pjesëmarrja në arsimin joformal sipas kategorisë së të hyrave (n=336)



Korrelacioni pozitiv mes nivelit të arsimit dhe nivelit të pjesëmarrjes është i dukshëm edhe në arsimin joformal. Ngjashëm me arsimin formal, pjesëmarrja në aktivitetet e arsimit joformal është më e lartë tek të rriturit me nivele të larta të arritjeve arsimore (figura 29).

Figura 29.


Pjesëmarrja në arsimin joformal sipas nivelit arsimor (n=336)




Megjithëse disa aktivitete zhvillohen gjatë orarit të punës, jo të gjitha financohen nga punëdhënësit. Vetëm një e katërta e pjesëmarrësve raportuan se punëdhënësit e tyre e kanë paguar (pjesërisht ose plotësisht) pjesëmarrjen në aktivitetin e të nxënësve joformal. Aktivitete të tilla janë frekuentuar për qëllime personale ose jo të lidhura me punën për gjysmën e pjesëmarrësve, ndërsa gjysma tjetër i kanë frekuentuar aktivitetet e të nxënësve joformal për qëllime të lidhura me punën. Sidoqoftë, vetëm 37 për qind e pjesëmarrësve kanë marrë pjesë në aktivitetet e tyre të të nxënësve joformal gjatë orëve të punës (me pagesë) (figura 30).

Figura 30.

Marrëdhënia punë-veprimtari joformale (n=304)




Ata që nuk kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet joformal renditën disa arsye ose pengesa që i penguan të merrnin pjesë. Arsyet dhe detyrimet familjare ndaj familjeve të tyre u konsideruan pengesa kryesore për 13 për qind të atyre që nuk kanë marrë pjesë. Të tjerët nuk kishin nevojë për aftësim shtesë për punën e tyre aktuale (12.5%) ose thjesht nuk e konsideronin të nevojshëm arsimin e mëtejshëm ose aktivitetet trajnuese (11%). Edhe ngarkesa profesionale u rendit ndër pengesat kryesore; përkundër nevojës dhe dëshirës për të ndjekur aftësim ose aktivitete të tjera të arsimit joformal, koha e kufizuar për të marrë pjesë në aktivitete të tilla për shkak të ngarkesave të lidhura me punën konsiderohet si pengesë kryesore për 9 për qind të atyre që nuk kanë marrë pjesë. Lista e plotë e pengesave paraqitet në figurën 31 më poshtë.

Figura 31.**Arsyet për mospjesëmarrje në arsimin joformal (n=2087)**

Nga ana tjetër, përmirësimet në perspektivat e karrierës (17%) dhe performancën në punë (17%) u deklaruan si arsyt kryesore të pjesëmarrjes nga ata që kanë marrë pjesë në arsim joformal brenda 12 muajve të fundit. Përmirësimi i shkathtësive ekzistuese ose të nxënit e shkathtësive të reja që mund të jenë të dobishme në jetën e përditshme të të rriturve, konsiderohet si arsyeja kryesore për pjesëmarrje nga një e katërta e pjesëmarrësve, ndërsa mbajtja e punës është arsye e rëndësishme për një përqindje të vogël (5%) të tyre (figura 32).

Figura 32.


Arsyet për pjesëmarrje në arsimin joformal (n=304)



Kostot e lidhura me arsimin joformal/aktivitetet e të nxënit, edhe pse kryesisht të financuara nga vetë pjesëmarrësit, ishin relativisht të ulëta. Sidoqoftë, kjo duhet të vlerësohet në përputhje me të hyrat e disponueshme familjare. Për familjet me të hyra të ulëta, në veçanti, kjo shumë përfaqëson një investim të konsiderueshëm. Vlera mesatare për një aktivitet të vetëm është 180 euro, çka është pothuajse ekuivalente me pagën minimale mujore në Kosovë (d.m.th. 170 euro), ndërsa kostoja mesatare e një aktiviteti të vetëm ishte më e lartë (230 euro).

Figura 33.


Kostot e aktiviteve të të nxënit joformal (n=304)



Pavarësisht nga burimet e financimit dhe kostot e aktiviteteve të arsimit/të nxënësve joformal, pjesëmarrja dhe certifikimi i aktivitetit kërkohej nga punëdhënësi, organet profesionale ose ligji për vetëm 35 për qind të pjesëmarrësve, ndërsa për një të tretën e pjesëmarrësve nuk vlente asnjë nga sa më lart. Rreth 30 për qind e pjesëmarrësve raportuan se pjesëmarrja në një aktivitet arsimor joformal nuk ka çuar në një certifikatë, por në vend të kësaj jepet një mirënjohje për pjesëmarrjen (figura 34).

Figura 34.

Certifikimi i aktiviteteve të nxënësve joformal (n=304)



Të nxënit informal


Kjo anketë u fokusua edhe në një aspekt tjetër që do të diskutohet në këtë pjesë, i cili është të nxënit informal në Kosovë. Para se të jepen gjetjet, do të shpjegojmë se çka nënkupton kjo formë e të nxënit. Të nxënit informal i referohet të nxënit që zhvillohet jashtë mjediseve formale të të nxënit, por në kuadër të një lloji qëllimi dhe kornize organizative. Sipas llogaritjeve tona, më shumë se 78 për qind e të anketuarve kanë marrë pjesë në të nxënit informal gjatë 12 muajve të fundit; mes tyre, 53 për qind janë burra dhe 47 për qind janë gra.

Figura 35 tregon shkallën e pjesëmarrjes së secilës grupmoshë në të nxënit informal (vija); veç kësaj, kolonat në këtë figurë japin informacion në

lidhje me strukturën gjinore brenda grupmoshës. Duke e analizuar këtë figurë, vërejmë se të rriturit e rinj marrin pjesë në këtë formë të të nxënit më shpesh sesa personat më të vjetër në moshë. Kjo mund të jetë për shkak se të rinjtë kanë më shumë njohuri për përdorimin e teknologjisë, e cila, sot për sot, është burim i rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve të të nxënit informal. Kjo arsye mund ta shpjegojë deri diku edhe modelin tjetër që vëzhgojmë, se gratë përfaqësohen më shumë në grupmoshat më të reja. Një faktor tjetër që mund ta shpjegojë modelin e përmendur është fakti se gratë më të reja janë më të përfaqësuara në tregun e punës dhe, për këtë arsye, duhet të zhvillojnë shkathtësi të ndryshme më shumë sesa gratë më të vjetra në moshë.

Figura 35.


Pjesëmarrja në të nxënit informal sipas grupmoshës dhe strukturës gjinore (n=1874)



Duke qenë se aktivitetet e të nxënit informal janë përgjithësisht më pak të kushtueshme në krahasim me arsimin formal ose joformal, janë shumë më të ulëta ndryshimet në shkallën e pjesëmarrjes në të nxënit informal brenda kategorive të të hyrave. Shkalla e pjesëmarrjes është 57 për qind në familjet me të hyra mujore deri në 250 euro, ndërsa është rreth 85 për qind në familjet që fitojnë më shumë se 2,000 euro në muaj (figura 36).

Figura 36.


Pjesëmarrja në aktivitetet e të nxënit informal sipas kategorisë së të hyrave (n=1874)



Modelet e shkallës së pjesëmarrjes në aktivitetet e të nxënimit informal - për dallim nga arsimi formal dhe joformal - tregojnë një nivel të lartë të pjesëmarrjes, pavarësisht nga niveli i arsimit. Me përjashtim të të rriturve me nivel arsimor fillor ose më të ulët, më shumë se 60 për qind e të rriturve në çdo kategori të arritjeve arsimore kanë marrë pjesë në aktivitete të të nxënimit informal gjatë vitit të fundit (figura 37).

Figura 37.


Pjesëmarrja në aktivitetet e të nxënimit joformal sipas nivelit arsimor (n=1874)



Kur flitet për llojet e të nxënit informal, të anketuarve iu kërkua të zgjedhin aktivitetet e të nxënit informal në të cilat ishin përfshirë. Siç tregohet në figurën 38, të nxënit duke përdorur kompjuterë ishte opsioni më i zgjedhur, i ndjekur nga të nxënit duke përdorur materiale të shtypura dhe të nxënit përmes televizionit/radios/videove. Nga ana tjetër, të nxënit nga një anëtar i familjes, një shok ose një kolegu ishte opsioni më pak i zgjedhur; vlen të përmendet se anketa u krye gjatë COVID-19, çka mund të shpjegonte pse ky lloj nuk zgjidhej shpesh.

Figura 38.


Lloji i aktiviteteve të të nxënit informal (n=1874)



Për të kontrolluar nëse ka ndonjë dallim mes grupmohave në lidhje me llojin e aktiviteteve të të nxënit informal, në figurën 39 kemi analizuar strukturën e aktiviteteve të të nxënit informal sipas grupmohës. Siç mund të shihet, aktiviteti më i zakonshëm në mesin e të rinjve (ata të moshave 18-24 dhe 25-34 vjeç) është të nxënit duke përdorur kompjuterë. Edhe pse ky është një opsion i zgjedhur gjerësisht edhe mes personave më të vjetër në moshë (ata të moshave 45-54 dhe 55-65 vjeç), aktivitetet më të zakonshme për ta janë të nxënit përmes televizionit/radios/videove dhe të nxënit duke përdorur materiale të shtypura. Siç është përmendur tashmë, njohuritë për teknologjinë mund ta shpjegojnë këtë dallim mes grupmohave.

Figura 39.

Lloji i aktiviteteve të të nxënit informal sipas grupmohës (n=1874)



Siç tregohet nga dëshmitë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë marrë pjesë në të nxënit informal, ndër të cilët të rinjtë dhe burrat më shpesh. Veç kësaj, ne analizuam llojin e aktiviteteve të të nxënit informal në të cilat kanë

marrë pjesë të anketuarit. Teksa të nxënit duke përdorur kompjuterë është më i zakonshëm tek të rinjtë, personat më të vjetër në moshë më shpesh i referohen pjesëmarrjes në të nxënit përmes televizionit/radios/videove.

Perceptimet për të nxënit e të rriturve


Përveç gjetjeve kryesore në lidhje me arsimin formal dhe joformal të paraqitura në pjesët e mëparshme, kjo pjesë do të diskutojë gjetjet në lidhje me perceptimin për të nxënit e të rriturve në Kosovë. Këto gjetje fokusohen në temat që karakterizojnë perceptimin për të nxënit e të rriturve duke përfshirë moshën, ndjenjën publike në lidhje me arsimin, subjektet përgjegjëse për mundësitë e arsimit për të rritur, mënyrën e preferuar të të nxënit, aktivitetet e përshtatshme për zhvillimin e shkathtësive të lidhura me punësimin, faktorët ndikues për të gjetur një punë të mirë.

Sa i përket perceptimit për të nxënit e të rriturve në aspektin e moshës, të anketuarve iu

kërkuar të vlerësojnë në çfarë mase pajtohen me pohimet e lidhura me moshën, të paraqitura në figurën 40. Në përgjithësi, ekziston një perceptim se të nxënit pas moshës 30 vjeç është më i vështirë. Siç mund të shihet, më shumë se 60 për qind pajtohen kryesisht ose plotësisht se personat mbi 30 vjeç kanë tepër detyrime dhe nuk mundën ta vazhdojnë arsimin e tyre. Në të njëjtën kohë, shumica dërrmuese besojnë se personat nën 30 vjeç janë më të interesuar për të nxënit sesa personat më të vjetër në moshë. Për më tepër, për sa i përket të nxënit të shkathtësive të reja, rreth 75 për qind pajtohen që personat nën 30 vjeç e kanë më të lehtë ta bëjnë këtë.

Figura 40.


Perceptimet për të nxënit e të rriturve (n=2391)



Lidhur me ndjenjat publike në lidhje me arsimin, figura 41 tregon shkallën në të cilën të anketuarit pajtohen me disa pohime në lidhje me këtë çështje. Një pjesë e lartë e të anketuarve (41 për qind) pajtohen kryesisht ose plotësisht se arsimi për të rritur është vetëm për ata persona që kanë shumë kohë të lirë që duhet ta kalojnë. Më shumë se 50 për qind nuk pajtohen kryesisht ose aspak që vetëm ata që janë afër OJQ-ve të ndryshme e kanë mundësinë të marrin pjesë në aktivitete të arsimit për të rritur. Sa i përket pasurisë së një personi, 43 për qind nuk pajtohen kryesisht ose aspak që vetëm personat e pasur mund ta përballojnë aftësimin ose kualifikimin në aktivitete të arsimit për të rritur, rreth 34 për qind pajtohen me këtë pohim, dhe 24 për qind janë neutralë. Lidhur me programet arsimore për të rritur, më shumë se 49 për qind pajtohen që këto lloje programesh janë veçanërisht të dobishme për ata që punojnë në profesione si hidraulik, elektrikist, ndërtim dhe saldim, gati 30 për qind nuk pajtohen me këtë deklaratë, dhe 22 për qind as pajtohen dhe as nuk pajtohen.

Figura 41.


Ndjenja publike për të nxënit e të rriturve (n=2391)



Kur flitet për subjektet përgjegjëse për mundësitë e arsimit për të rritur, siç janë vendosja në vende të punës, certifikimi, financimi, organizimi dhe identifikimi i nevojave për trajnim, të anketuarit e përmendën më shpesh shtetin si subjektin përgjegjës për secilën mundësi. Figura 42 tregon se sa shpesh u zgjodh çdo subjekt si ai që duhet të ishte përgjegjëse për secilën mundësi arsimimi.

Figura 42.


Subjektet përgjegjëse për mundësitë e arsimit për të rritur (n=2391)



Në një rëndësi nga pyetjet, të anketuarve iu kërkua të renditnin mënyrën e preferuar të të nxënit nga 1 (më e preferuara) në 5 (më pak e preferuara). Figura 43 tregon frekuencën relative të secilës mundësi të zgjedhur. Teksa mënyra më e preferuar është të nxënit formal, pasi u rendit si e para nga 66 për qind e të anketuarve, mënyra më pak e preferuar janë kurset dhe format e tjera të arsimit joformal, pasi u rendit më shpesh si më pak e preferuara në krahasim me mënyrat e tjera.

Figura 43.


Mënyra e preferuar e të nxënit (n = 2391)



Në një pyetje tjetër, të anketuarit duhej të zgjidhnin njërën nga tri aktivitetet e ndryshme të të nxëniet si më e përshtatshme për të zhvilluar disa faktorë të lidhur me punësimin. Figura 44 ilustron se sa shpesh u zgjodh si i përshtatshëm secili aktivitet për të ndërtuar shkathtësitë specifike. Siç tregohet, frekuentimi i universitetit (ose institucionit, kolegjit profesional, shkollave profesionale, gjimnazit) është zgjedhur si aktiviteti më i rëndësishëm i të nxëniet për ta zhvilluar veten si person, për të marrë një kualifikim të njohur, për të marrë një ngritje në detyrë ose pagë më të mirë, për të pasur siguri më të madhe të punës, për shanse më të mira për të gjetur një punë më të mirë, dhe për të mësuar gjëra të reja. Nga ana tjetër, pjesëmarrja në trajnime, punëtori, seminare, mësimet private janë mënyra më të rëndësishme për të takuar njerëz/për të zgjeruar rrjetin profesional dhe për të zhvilluar shkathtësi praktike, sipas të anketuarve.

Figura 44.


Aktivitetet e të nxëniet të përshtatshme për secilën shkathtësi (n=2391)



Lidhur me faktorët që janë të rëndësishëm për gjetjen e një pune të mirë, figura 45 jep informacion për frekuencë relative që u zgjodh secili faktor si një nga tre faktorët më të rëndësishëm. Pasja e lidhjeve u zgjodh më shpesh (më shumë se 18 për qind) si një nga tre faktorët më të rëndësishëm, ndjekur nga arsimi, i cili u zgjodh nga 17.9 për qind, dhe aftësitë profesionale dhe përvoja e punës nga 16 për qind.

Figura 45.

Faktori ndikues për të gjetur një punë më të mirë (n=2391)



Si përfundim, ekziston një perceptim se arsimi për personat mbi 30 vjeç është më i vështirë, shiteti është subjekti që konsiderohet më përgjegjës për mundësitë e arsimit për të rritur; lidhjet janë një faktor i fortë për të gjetur një punë të mirë,


ndërsa frekuentimi i universitetit është një aktivitet i rëndësishëm për të përmirësuar shanset për të gjetur një punë më të mirë, kurse frekuentimi i trajnimeve dhe formave të tjera të arsimit joformal për të zhvilluar shkathtësi të lidhura me punën.

Të nxënit në distancë gjatë COVID-19

Duke qenë se anketa u krye gjatë pandemisë COVID-19, disa nga pyetjet e anketës kishin në fokus disa aspekte të të nxënit në distancë gjatë kësaj kohe, të cilat do të diskutohen në këtë pjesë. Lidhur me pjesëmarrjen, më shumë se 9 për qind e të anketuarve pohuan se kanë marrë pjesë në këtë lloj të të nxënit.

Figura 46.

Të anketuarit që marrin pjesë në të nxënit në distancë sipas formës së arsimit (n=223)



Nga ata që kanë marrë pjesë në të nxënit në distancë, siç tregohet në figurën 46, më shumë se 76 për qind thanë se kanë marrë pjesë në arsimin formal, pothuajse 18 për qind në arsimin joformal, dhe 5.4 për qind në forma të tjera të arsimit.

Figura 47.

Të anketuarit që marrin pjesë në arsimin online sipas gjinisë dhe zonës së banimit (n=223)





Figura 47 tregon shpërndarjen e të anketuarve që kanë marrë pjesë në të nxënit në distancë për sa i përket gjinisë dhe zonës së banimit. Siç mund të shihet, gratë kanë marrë pjesë më shumë se burrat. Lidhur me zonat e banimit, ata që jetojnë në zonat rurale kanë marrë pjesë më shumë sesa ata që jetojnë në qytete dhe periferi. Në njërin nga pyetjet, të anketuarve iu kërkua të përmendnin arsyen (arsyet) për pjesëmarrjen në të nxënit në distancë. Arsyeja më e zakonshme e përmendur është koha shtesë që mund të kalonin në arsim gjatë mbylljeve për shkak të COVID-19. Figura 48 jep informacion të detajuar për arsyet e pjesëmarrjes në të nxënit në distancë.

Figura 48.


Arsyet për pjesëmarrje në të nxënit në distancë (n=223)



Kur të anketuarve iu kërkua të jepnin informacion në lidhje me aktivitetet arsimore në të cilat kanë qenë të përfshirë gjatë pjesëmarrjes në të nxënit në distancë, kryerja e detyrave online të caktuara nga mësimitdhënësi/instruktori duket se është përgjigjja më e zakonshme. Aktivite- te të tjera arsimore që u përmendën më shpesh përfshijnë pjesëmarrjen në klasa virtuale me mësimitdhënësi/instruktor dhe përdorimi i aplikacioneve mobile për të nxënit. Figura 49 ofron më shumë informacion në lidhje me aktivitetet arsimore në të cilat janë angazhuar të anketuarit.

Figura 49.


Aktivitetet gjatë të nxënit në distancë (n=223)



Atyre që kanë marrë pjesë në të nxënit në distancë iu kërkua të përmendnin disavantazhet e kësaj forme të të nxënit në krahasim me të nxënit në klasë. Figura 50 ilustron frekuencën relative të secilit disavantazh të zgjedhur të renditur, duke paraqitur nga ai më i zakonshëm tek ai më pak i zakonshëm. Fakti që aktivitetet praktike nuk janë të mundshme në të nxënit në distancë, paraqet disavantazhin më të madh, pasi u përmend më shpesh nga të anketuarit.

Figura 50.


Disavantazhet e të nxënit online (n=223)



Nga ana tjetër, figura 51 tregon se sa shpesh të anketuarit e përmendën secilin përfitim të të nxënit në distancë krahasuar me të nxënit në klasë. Përfitimi më i përmendur nga të anketuarit është se nuk ka kosto të transportit (kursehen paratë nga transporti publik), i ndjekur nga fakti se nuk ka nevojë të udhëtohet për në institucionin arsimor duke kursyer kohë, dhe qasja në të nxënit duke jetuar në lokacione më pak të kushtueshme.

Figura 51.


Përfitimet nga të nxënit në distancë (n=223)



Në pyetjen e fundit në lidhje me të nxënit në distancë gjatë COVID 19, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin se sa ishin të kënaqur me cilësinë e arsimit online që morën. Rezultatet ilustrohen në figurën 52; teksa pothuajse 78 për qind e të anketuarve ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me cilësinë e arsimit online, pjesa e mbetur (më shumë se 22 për qind) ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur.

Figura 52.

Kënaqshmëria me cilësinë e të nxënit në distancë (n=223)



Siç u tregua nga të dhënat e mësipërme, gjatë COVID-19, gratë morën pjesë më shumë në të nxënit në distancë sesa burrat, dhe arsyeja kryesore e pjesëmarrjes ishte koha shtesë si pasojë e mbylljes. Kryerja e detyrave online të caktuara nga një mësimdhënës/instruktor ishte aktiviteti kryesor arsimor gjatë të nxënit në distancë. Disavantazhet kryesore të të nxënit në distancë, sipas të anketu-

arve, janë mungesa e aktiviteteve praktike dhe vërshtirësia për të bashkëvepruar me instruktorin dhe shokët e klasës. Nga ana tjetër, përfitimet kryesore janë se ul kostot pasi nuk ka nevojë të udhëtosh për në institucionin arsimor ose të jetosh pranë tij, dhe gjithashtu kursehet kohë. Në përgjithësi, ata që kanë marrë pjesë në të nxënit në distancë ishin të kënaqur me cilësinë e arsimit të marrë.

Shënime përmbyllëse

Ky raport i anketës ofron një vlerësim të plotë të temave që lidhen me arsimin për të rritur në Kosovë. Ai shqyrton arritjet aktuale arsimore dhe më në thellësi dy lloje të aktiviteteve arsimore gjatë vitit të kaluar - arsimin formal dhe atë joformal. Rezultatet e paraqitura në këtë raport plotësojnë të dhënat ekzistuese mbi arsimin dhe gjithashtu mund të kontribuojnë në politikëbërjen e informuar në sektorin e arsimit në Kosovë. Gjetjet kryesore nga anketa janë si më poshtë:

- Prirja për të migruar mbetet një nga sfidat më të mëdha që përfundimisht do të paraqesë implikime serioze në tregun e punës në Kosovë; më shumë se 34 për qind e të rriturve planifikojnë të jetojnë dhe/ose të punojnë në një vend tjetër brenda tre viteve të ardhshme. Arsyet më të zakonshme për ta bërë këtë përfshijnë kushtet më të mira të punës, pagat më të larta dhe qasjen më të lehtë në tregun e punës.
- Arritjet arsimore në Kosovë janë relativisht të larta të pranë mesatares së BE-së. Bazuar në të dhënat e anketës, më shumë se një e treta e të rriturve në Kosovë kanë përfunduar një program të arsimit të lartë, ndërsa vetëm rreth 2 për qind kanë vetëm arsim fillor ose edukim të fëmijërisë së hershme. Arritjet arsimore të grave janë sistematikisht më të larta sesa të burrave, përveç në nivele të doktoraturës ose diploma ekuivalente.
- Tregu i punës dominohet nga punëtorët e shërbimeve dhe shitjeve, si dhe profesionistët, siç janë. profesionistët e shëndetit, profesionistët e mësimdhënies, etj. me më shumë se gjysmën e të rriturve të punësuar. Mes të të rriturve të punësuarve, shumica e profesioneve dominohen nga burrat; veçanërisht operatorët e impianteve dhe makinerve, punëtorët zejtarë dhe të aktiviteteve shoqëruese, si dhe punëtorët e bujqësisë.
- Njohuritë për të nxënit e gjuhëve të huaja janë relativisht të kënaqshme; sipas rezultateve të anketës, më shumë se 66 për qind mund të flasin të paktën një gjuhë të huaj ose më shumë. Gjuha angleze është gjuha e huaj më e folur.
- Gratë tregojnë më shumë interes kur flitet për mundësitë e të nxënit; një e treta e të rriturve të anketuar kanë kërkuar informacion në lidhje me mundësitë e të nxënit. Burimet kryesore të informacionit rreth mundësive të të nxënit mbeten interneti, duke përjashtuar rrjetet sociale.
- Vetëm 14 për qind e të rriturve kanë marrë pjesë në ndonjë lloji arsimit gjatë 12 muajve të fundit, nga të cilët pothuajse 60 për qind janë gra. Pjesëmarrja më e lartë e grave është më e theksuar në mesin e gjeneratave më të reja, ndërsa e kundërta manifestohet tek të rriturit në të dyzetat dhe të pesëdhjetat. Pjesëmarrësit në arsimin formal shpesh ndjekin programe në fushën e edukimit dhe biznesit, administrimit dhe juridikut, dhe një varg fushash të tjera. Vetëm teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), inxhinieria, ndërtimi dhe bujqësia, dominohen nga burrat, ndërsa profilet e tjera duket se janë më tërheqëse për gratë. Për më tepër, më shumë se gjysma e të rriturve që kanë marrë pjesë në aktivitete të arsimit formal deklaruan se nuk kanë punuar gjatë periudhës së studimit.

- Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin formal si dhe atë joformal është më e lartë tek të rriturit me nivele të larta të arritjeve arsimore (p.sh. të diplomuarit dhe pasuniversitarët). Sidoqoftë, shkalla e pjesëmarrjes në aktivitetet e të nxënimit informal është e lartë, pavarësisht nga arritjet arsimore.
- Kushtet socio-ekonomike duket se janë ndër pengesat më të zakonshme ndaj pjesëmarrjes në arsimin formal.
- Pjesëmarrja në të gjitha llojet e aktiviteteve joformale është e ulët, me vetëm 13 për qind të të rriturve. Ngjashëm me arsimin formal, niveli i pjesëmarrjes së grave është më i lartë.
- Angazhimi për të nxënimit varet shumë nga motivimi i individëve dhe burimet e tyre, pasi punëdhënësit përfshihen mjaft pak. Vetëm 25 për qind e të rriturve raportuan se punëdhënësit e tyre paguanin, pjesërisht ose plotësisht, për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin joformal.
- Pjesëmarrja në arsimin formal dhe joformal tregon marrëdhënie pozitive me të hyrave mujore të familjes. Sa më të larta të hyrat, aq më e lartë është shkalla e pjesëmarrjes.
- Teksa kostot e larta ndonjëherë përmenden si një arsye për mospjesëmarrje, janë kryesisht koha e disponueshme dhe mungesa e nevojës që kryesisht pengojnë pjesëmarrjen në arsim.
- Institucionet shtetërore perceptohen si aktorët kryesorë përgjegjës për mundësitë e arsimit për të rritur në të gjitha aspektet, p.sh. vendosja në vende të punës, certifikimi, financimi, organizimi dhe identifikimi i nevojave për trajnim.
- Arsyet familjare dhe detyrimet ndaj familjeve të tyre u konsideruan si disa nga pengesat më të mëdha ndaj pjesëmarrjes në aktivitete të arsimit joformal. Nga ana tjetër, të rriturit i konsiderojnë përmirësimet në perspektivat e tyre të karrierës dhe performancën e tyre të punës, si arsyt kryesore për të marrë pjesë në aktivitete të tilla.
- Aktiviteti më i zakonshëm i të nxënimit informal mes të rinjve (d.m.th. të rriturit e moshave 18-24 dhe 25-34 vjeç) është të nxënimit duke përdorur kompjuterë, ndërsa aktivitetet më të zakonshme të grupmoshës më të vjetër (d.m.th. të rriturit mes 45 dhe 65 vjeç) janë të nxënimit përmes televizionit dhe/ose radio si dhe të nxënimit nga materiale të shtypura.
- Më shumë se 9 për qind e të rriturve raportuan se kanë marrë pjesë në aktivitete në distancë për shkak të kufizimeve të lidhura me pandeminë COVID-19. Ashtu si në format e tjera të arsimit, niveli i pjesëmarrjes ishte më i lartë tek gratë në krahasim me burrat. Arsyja më e zakonshme për të marrë pjesë në këtë lloj aktiviteti të të nxënimit ishte koha shtesë që të rriturit kishin të disponueshme/të lirë për ta shpenzuar në arsim gjatë mbylljes për shkak të COVID-19.
- Disavantazhi më i madh që raportohet nga të rriturit në lidhje me të nxënimit në distancë, ishte pamundësia për t'u përfshirë në aktivitete praktike. Nga ana tjetër, avantazhet më të mëdha konsiderohen kostot e ulëta të transportit dhe koha e kursyer nga mos udhëtimi. Shumica e pjesëmarrësve ishin të kënaqur me cilësinë e arsimit që morën nga aktivitetet e të nxënimit në distancë.

Anekse

Aneksi 1. Shpërndarja e mostrës

Komuna	Popullata +18			Raporti urban / rural			Përmasa e mostrës		
	Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej
Deçan	2,351	22,200	24,551	9.6%	90.4%	2.3%	5	50	55
Dragash	722	20,626	21,347	3.4%	96.6%	2.0%	2	46	48
Ferizaj	25,777	38,192	63,969	40.3%	59.7%	6.0%	58	85	143
Fushë Kosovë	10,738	10,061	20,799	51.6%	48.4%	1.9%	24	22	46
Gjakovë	25,886	31,302	57,188	45.3%	54.7%	5.3%	58	70	128
Gjilan	33,734	21,489	55,223	61.1%	38.9%	5.2%	75	48	123
Drenas	3,694	30,541	34,235	10.8%	89.2%	3.2%	8	68	76
Graçanicë	-	6,805	6,805	0.0%	100.0%	0.6%	0	15	15
Hani i Elezit	-	5,525	5,525	0.0%	100.0%	0.5%	0	12	12
Istog	3,116	20,482	23,598	13.2%	86.8%	2.2%	7	46	53
Junik	-	3,686	3,686	0.0%	100.0%	0.3%	0	8	8
Kaçanik	6,372	13,414	19,786	32.2%	67.8%	1.8%	14	30	44
Kamenicë	4,676	17,963	22,639	20.7%	79.3%	2.1%	10	40	51
Klinë	3,570	18,711	22,281	16.0%	84.0%	2.1%	8	42	50
Kllokot	-	1,544	1,544	0.0%	100.0%	0.1%	0	3	3
Leposaviq	-	9,234	9,234	0.0%	100.0%	0.9%	0	21	21
Lipjan	4,144	29,440	33,584	12.3%	87.7%	3.1%	9	66	75
Malishevë	1,844	27,302	29,146	6.3%	93.7%	2.7%	4	61	65
Mamushë	-	3,058	3,058	0.0%	100.0%	0.3%	0	7	7
Mitrovicë	28,058	15,083	43,141	65.0%	35.0%	4.0%	63	34	96
Mitrovicë e Veriut	5,811	2,862	8,673	67.0%	33.0%	0.8%	13	6	19
Novobërdë	-	4,294	4,294	0.0%	100.0%	0.4%	0	10	10
Obiliq	4,033	8,616	12,649	31.9%	68.1%	1.2%	9	19	28
Partesh	-	1,207	1,207	0.0%	100.0%	0.1%	0	3	3
Pejë	30,955	28,808	59,763	51.8%	48.2%	5.6%	69	64	133
Podujevë	13,842	37,541	51,384	26.9%	73.1%	4.8%	31	84	115
Prishtinë	102,220	22,207	124,427	82.2%	17.8%	11.6%	228	50	278
Prizren	58,611	48,361	106,972	54.8%	45.2%	10.0%	131	108	239
Rahovec	9,623	23,405	33,028	29.1%	70.9%	3.1%	21	52	74
Ranillug	-	2,748	2,748	0.0%	100.0%	0.3%	0	6	6
Shtime	4,212	11,187	15,400	27.4%	72.6%	1.4%	9	25	34
Skënderaj	4,033	25,641	29,674	13.6%	86.4%	2.8%	9	57	66
Shtërpcë	875	3,532	4,407	19.9%	80.1%	0.4%	2	8	10
Suharekë	6,317	28,579	34,896	18.1%	81.9%	3.3%	14	64	78
Viti	2,812	24,192	27,004	10.4%	89.6%	2.5%	6	54	60
Vushtrri	16,483	25,270	41,753	39.5%	60.5%	3.9%	37	56	93
Zubin Potok	-	5,951	5,951	0.0%	100.0%	0.6%	0	13	13
Zveçan	-	4,971	4,971	0.0%	100.0%	0.5%	0	11	11
Gjithsej	242,368	828,168	1,070,536	22.6%	77.4%	100%	926	1,465	2,391

